



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16 ,17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit nr. 03/l-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 25.07.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR LIRIMIN NGA PAGESA E TAKSAVE PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE -TARASAVE , VENDPARKINGJEVE PËR OPERATORËT AUTO TAKSI DHE QIRAMARRËSIT E LOKALEVE NË PRONËSI TË KOMUNËS

I. Me këtë Vendim, **LIROHEN** , nga pagesa e taksës/qirasë komunale :

- a. Subjektet e biznesit për shfrytëzimin e hapësirave publike-tarasave, përgjatë rrugës " Lidhja e Prizrenit në qytetin e Lipjanit,
- b. Qiramarrësit e lokaleve në pronësi të komunës, përgjatë rrugës "Lidhja e Prizrenit" në qytetin e Lipjanit dhe
- c. Operatorët auto taksi që shfrytëzojnë vendparkingjet në pronësi të komunës në gjithë territorin e qytetit të Lipjanit.

II. Subjektet e biznesit për shfrytëzimin e hapësirave publike-tarasave, operatorët auto taksi dhe qiramarrësit e lokaleve në pronësi të komunës do të lirohen nga pagesa e taksës komunale sipas pikës I të këtij Vendimi për shkak të zhvillimit të punimeve nga operatori ekonomik sipas Projektit: Ndërtimi i nënkalimit, vazhdimi i ndërtimit të sheshit, ndërtimi i parkut qëndror të qytetit dhe parkingut nëntokësor në Lipjan, i cili projekt gjatë implementimit në teren ua ka vështirësuar subjekteve të cekura që ti shfrytëzojnë hapësirat publike, përkatësisht tarasat para lokalit të tyre afarist , shfrytëzimin e vendparkingjeve publike të cekura në pikën I për operatorët auto taksi si dhe për qiramarrësit për lokalet në pronësi të komunës.

III. Lirimi nga pagesa e taksave/qirasë komunale bëhet për vitin 2024, ndërsa për subjektet që kanë bërë pagesën për këtë vit do të aplikohet lirimi nga pagesa për vitin e ardhshëm.

IV.Mjetet që inkasohen nga taksat dhe qiraja janë të hyra vetanake dhe regjistrohen në Drejtoratin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim në kodin 1/613/18163/50405/00000/0451 për taksat dhe në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim në kodin 21/613/48003/50408/00000/0411 për qiratë nga lokalet nga dhënia në shfrytëzim e pronës publike.

V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime , Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Zyra e Kryetarit të Komunës- Sektori pronësor-juridik dhe Drejtorati për Inspeksion.

VI. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

15 Nr. 353/01-35828
Lipjan, më 25.07.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi